

URDHËR
Nr. 231, datë 29.3.2019

PËR NDALIMIN E PESHKIMIT NË LIQENIN E SHKODRËS

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 1, të nenit 13, të ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”, të ndryshuar, si dhe të pikës 2, të nenit 4, të rregullores nr. 1, datë 7.3.2014 “Për zbatimin e ligjit nr. 64/2012, datë 31.5.2012 “Për peshkimin”“, të ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural

URDHËROJ:

1. Ndalimin e peshkimit, me çfarëdo lloj mjeti dhe metode gjuetie, si dhe mbajtjen në bord, tranzitim në barkë, zbarkimin e qëllimtë dhe hedhjen në treg ose për konsum i të gjitha llojeve të peshqve në liqenin e Shkodrës, nga data 1.4.2019 deri më 30.4.2019.

2. Për periudhën 1.5.2019-30.6.2019, ndalimin e peshkimit me rrjeta në fashën breg/liqenore prej 250 ml nga bregu.

3. Vendbazimi i varkave të peshkimit do të jetë në zonat e përcaktuara nga OMP-ja.

4. Për zbatimin e këtij urdhri, të hartohet një plan i përbashkët operativ veprimi nga Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në koordinim me OMP-në e këtij liqeni.

5. OMP-ja të marrë të gjitha masat e zhvendosjes së objekteve ku peshqit kanë lëshuar vezët, në rastet e rënies së nivelit të ujit në liqenin e Shkodrës.

6. Ngarkohet Drejtoria e Politikave dhe Strategjive të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural, Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në vartësi të së cilës është Sektori i Monitorimit dhe Kontrollit të Peshkimit, Organizata e Menaxhimit të Peshkimit të liqenit të Shkodrës, që të monitorojnë zbatimin e Planit Operativ të Veprimit për zbatimin e këtij urdhri, duke bashkëpunuar me strukturat e qeverisjes vendore Shkodër e Malësi e Madhe, Drejtorinë e Policisë së Rendit dhe atë Kufitare në Qarkun e Shkodrës si dhe me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit (AKU) të qarkut Shkodër.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Bledar Çuçi